

STATUT
“ICV HOUSE”

NËNI 1

1.1 Emertimi Shoqërisë “ICV HOUSE” Sh.P.K, Quajtur Shoqëria

NENI 2

PERSONALITËTI JURIDIK

2.1 Shoqëria fiton personalitet juridik me rregjistrimin e saj në Rregjistrin Tregtar pranë Qendres Kombetare të Biznësit.

NENI 3

SELIA

3.1 Selia e Shoqërise në adresën: Njësi me sipërfaqe 16.2 m2, Bulevardi/Rruga Bajram Curri, e regjistruar në zk.8160, vol.39 fq.56, me nr pasurie 2/276-N30 të ZVRPP Tiranë.

3.2 Shoqëria mund të hapë dhe të mbaje zyra dhe /ose të kryej aktivitetë në vende të tjera, brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe të hapë ose mbyll zyra në vende të ndryshme, përveç selisë së Shoqërise, brenda territorit Shqiptar .

NENI 4

KOHEZGJATJA

4.1 Kohëzgjatja e Shoqërise është për një periudhë kohe të përcaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

NENI 5

OBJEKTI

5.1 Objekti I shoqërise do të konsistojë në:

Objekti i Shoqërise përfshin Shitje me shumicë e pakice e tekstileve, veshjeve, veshjeve sportive, këpucëve dhe artikujve të lëkures. Import, eksport, shitje me shumicë dhe pakicë e lodrave duke përfshirë por pa u kufizuar në to, lodra dhe figura të licencuara dhe lojra me plastelinë. Industri veshjeje, import-eksport, tregtim dhe shitje me pakice e shumice të mallrave, sipermarrje dhe shërbime në fusha të ndryshme. Gjithashtu, në përputhje me legjislacionin Shqiptar, Shoqëria mund të kryejë dhe realizojë çdo aktivitet që lidhet direkt ose indirekt, që është pasojë, apo e lidhur me aktivitetet e listuara me lart. Për të arritur qëllimin e mësipërm, Shoqëria mund të ndërmerret çdo aktivitet dhe shërbim qoftë tregtar, financiar, për dhenie me qira apo hipotekim, që mund të konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm në menyrë që të arrihet objekti i Shoqërise.

Për këtë qëllim Shoqëria mund të veprojë si në Shqipëri dhe jashtë vendit. Kompania gjithashtu mund të veprojë nëpërmjet filialeve të saj apo të Shoqërive të kontrolluara prej saj. E gjithë kjo

në respektim të legjislacionit që rregullon çështjet specifike të listuara me siper, ndalimet, kufizimet dhe kerkesat ligjore dhe prandaj i nënshtrohen lejeve, autorizimeve dhe rregjistrimeve që mund të jenë të nevojshme me perputhje me të gjithë kushtet e tjera.

Shoqëria mundet se fundi në menyre industriale të kryej çdo veprim tregtar në lidhje me pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme. Gjithashtu Shoqëria mund të kryej çdo aktivitet tjetër biznesi I cili nuk është i ndaluar nga ligji i zbatueshem në Republikën e Shqipërisë.

NENI 6

KAPITALI I SHOQËRISE

6.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerën 100 (njqind) leke, 1 KUOTË.

6.2 Kapitali I Shoqërise përbëhet tërësisht nga kontributë në para dhe zotërohet nga Ortaku vetëm i Shoqërisë:

- **Pamela Malasi**, e bija e Gëzim-it, e datëlindjes 31.12.1997, lindur në Ballsh dhe banues në Tiranë, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar e identifikuar prej letërnjoftim nr.033013259 dhe me nr. Personal J76231068T

6.3 Kuotat janë të zakonshme dhe lirisht të transferueshme sipas kushtëve të parashikuara në ligj dhe në Statut.

6.4 Pergjegjesia e Ortakut per humbjen e Shoqërise shtrihet deri në vleren e pashlyer kontributëve të nënshkruara.

NENI 7

ZMADHIMI I KAPITALIT

7.1 Zmadhimi I kapitalit behet me vendim të Asamblese se Pergjithshme sipas Nënit 13 të ketij Statuti.

7.2. Zmadhimi I kapitalit mund të behet me derdhje në para ose me kontributë në natyre. Në cdo rast keto kontributë mund të shoqerohen me nje certifikatë per nënshkrimin e tyre ose me nje raport vleresimi të kontributëve të kryer nga nja ekspert I vleresimit të kontributëve në natyre.

NENI 8

ZVOGELIMI I KAPITALIT

8.1 Zvogelimi i kapitalit behet me vendim të Asamblese se Pergjithshme me propozim të administratorit/eve, vetëm në rastin kur Shoqëria mund të pesoje humbje të tilla qe ta bejnë të domosdoshem këtë zvogelim.

8.2 Asambleja e Pergjithshme vendos per zvogelimin e kapitalit sipoas Nëni 13 të ketij Statuti.

NENI 9

TRANSFERIMI I KUOTAVE

9.1 Transferimi i kuotave të kapitalit të Shoqërise mund të behet me shitje, trashegimi, dhurim ose me cdo menyre tjetër të parashikuar nga ligji.

NENI 10

TRANSFERIMI TËK PERSONAT E TRETË

10.1 Në rast transferimi të kuotave tëk personat e tretë jashtë Shoqërise, me shitje ose me dhurim, ortaku qe synontë transferoj kuotat duhet t'i komunikoj ortëkeve të tjere vullnëtin e tij me shkrim, nëpermjet nje njoftimi drejtuar Administratorit. Ortaket e tjere kanë të drejtën e parablerjes se kuotave të ortakeve, me kushtë të barabarta dhe duhe të të ushtrojnë këtë të drejtë brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit të vullnëtit të ortakut per të transferuar kuotat.

10.2 Vlera e kuotës qe transferohet do percaktohet nga nje ekspert I emeruar nga ortaket me marreveshje ose nga Gjykata në rast se ortaket nuk bien dakort.

NENI 11

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

11.1 Asambleja e Pergjithshme eshtë organi me i lartë vendimarrës i Shoqërise merr vendime kur eshtë mbledhur rregullisht.

11.2 Vendimet e marra nga Asambleja e Pergjithshme e thirrur dhe e mbledhur rregullisht në perputhje me ligjin dhe me këtë Statut janë të detyrueshme per të gjithë ortaket perfshire ata qe mungojnë.

11.3 Asambleja e Pergjithshme mblidhet në rastët e parashikuara nga ky Statut dhe nga ligji në fuqi "Per tregtaret dhe Shoqëritë tregtare", ligje të tjera dhe sa here eshtë e nëvojshme per mbrojtjen e intëresave të Shoqërise.

11.4 Asambleja e Pergjithshme mbahet në selinë e Shoqërise ose në cdo vend tjetër të shenuar në njoftimin per mbledhje. Njoftimi per mbledhje i dergohet me shkrim të gjithë ortakeve jo me vonë se 7 (ditë) perpara datës se mbledhjes.

11.5 Mbledhja e Asambleja e Pergjithshme thirret nga administratoret. Thirrja e Asamblese se Pergjithshme mund të kerkohet dhe nga ortaku ose ortaket qe perfaqesojnë të paktën 5% të totalit të votave në Asambleja e Pergjithshme.

NENI 12

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

12.1 Asambleja mblidhet cdo vit brenda gjashtë muajve nga data e mbylljes se vitit financiar, per miratimin e raportit të administratoreve, pasqyrave financiare dhe llogarive vjetore.

12.2 Vendimet merren nga ortaket me të drejtë votë, të pranishem në mbledhjen e asamblese qe perfaqesojnë me shume se 30% të të gjithë kuotave të kapitalit të Shoqërise.

12.3 Në rastin e marrjes se vendimeve qe kerkojnë nje shumice të zakonshme, asambleja e pergjithshme mund të marr vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjese ortaket me të drejtë votë, qe zotërojnë me shume se 30% të kuotave. Në rastin kur asambleja e pergjithshme duhet të vendos per ceshtje, të cilat kerkojnë shumice të kualifikuar, sipas nënit 87 të ketij ligji nr.9901 datë 14.04.2008 “Per Tregaret dhe Shoqëritë Tregtare”, ajo mund të marr vendime të vlefshme vetën nëse ortaket qe zotërojnë me shume se gjysmen e numrit total të votave janë të pranishem personalisht, votojnë me shkrese apo me mjetë elektronike, sipas parashikimeve të pikes 3 të nënit 88 të ketij ligji. Nëse asambleja e pergjithshme mund të mblidhet per shkak të mungeses se kuotimit të permendur në piken 1 të ketij nëni, asambleja e pergjithshme mblidhet perseri jo me vonë se 30 ditë, me të njejtin rend ditë.

NENI 13

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

13.1 Asambleja e Pergjithshme thirret sa here eshtë e nevojshme per marrjen e vendimeve në interes të Shoqërise.

13.2 Vendimet qe kanë të bejnë me (por pa u kufizuar vetëm në to): ndryshimin e ketij statuti, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit të Shoqërise, ndryshimin thelbesor të objektit të veprimtarise se Shoqërise, ndarjen e fitimeve, prishjen e Shoqërise konsiderohen vendime të Asamblese.

13.3 Vendimet merren nga ortaket me të drejtë votë, të pranishem në mbledhjen e asamblese, qe perfaqesojnë të paktën 80% të të gjithë kuotave të kapitalit të Shoqërise.

NENI 14

PJESEMARRJA, VOTIMI DHE PERFAQESIMI

14.1 Secili ortak ka të drejtën e pjesëmarrjes dhe votimit në mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme. Votat e disponuara nga secili ortak janë me numer të barabartë me kuotat e zotëruara prej tij.

14.2 Secili ortak mund të perfaqesohet në mbledhjet e Asamblese nga nje ortak tjetër apo nga nje person I tretë me autorizim. Autorizimi mund të jepet vetëm per nje mbledhje të Asamblese se Pergjithshme e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me të njejtin rend ditë.

NENI 15

KOMPETENCAT E ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

15.1 Asambleja e Pergjithshme vendos per :

- percaktimin e politikave tregtare
- ndryshimin e Statutit

- emerimin dhe shkarkimin e Administratorit/eve dhe caktimin e shperblimit të tij/tyre.
- emerimin dhe shkarkimin e likuidatorit/eve dhe ekspertëve kontabel të autorizuar dhe shperlimet e tyre
- mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raportëve të ecurise se veprimtarise
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raportet e ecurise se veprimtarise
- miratimin e zmadhimit dhe zvogelimit të kapitalit të Shoqërisë
- pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- përfaqesimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedime të tjera kunder administratorit/eve
- shperndarjen e fitimeve
- riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë
- miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të Asamblese
- çeshtje tjetër të caktuar nga ligji ose nga ky Statut.

NENI 16

ADMINISTRATORI/ET

16.1 Shoqëria administrohet nga nje ose disa Administrator, i/të cili/ët është/janë person fizik, i/të zgjedhur brenda ose jashtë bashkesise se ortakeve, të cilet emerohen nga Asambleja e Pergjithshme.

16.2 Administratori/et emerohet/n per nje periudhe 5 (pese) vjecare, me të drejtë riemerimi.

16.3 Administratori/et shkarkohet/n nga detyra,në cdo kohe ,me vendim të zakonshem të Asamblese se Pergjithshme sipas ligjit.

16.4 Administrator i pare i Shoqërisë caktohet **Pamela Malasi**, e bija e Gëzim-it, e datëlindjes 31.12.1997, lindur në Ballsh dhe banues në Tiranë, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar e identifikuar prej letërnjoftim nr.033013259 dhe me nr. Personal J76231068T

16.5 Llogaria bankare të celet nga Ortaku i vetëm i Shoqërisë Znj.Pamela Gëzim Malasi.

16.6 Administratori i pare i Shoqërisë Znj.Pamela Gëzim Malasi, ka të drejtë të realizoje transferta, tërheqje apo cdo lloj veprimi tjetër në keto llogari.

16.7 Ortaku i vetëm i Shoqërisë Znj.Pamela Gëzim Malasi, ka të drejtë të realizoje transferta, tërheqje apo cdo lloj veprimi tjetër në llogaritë e Shoqërisë.

NENI 17

KOMPETËNCAT E ADMINISTRATORIT/EVE

17.1 Administratori/et është/janë përgjegjes për çështjet e përditshme të Shoqërisë dhe përfaqëson/jnë Shoqërinë në marrëdhënie me të tretët në përputhje me dispozitat e Statutit ose ligjit të zbatueshem.

17.2 Administratori/et ka/në të gjitha kompetencat e zakonshme dhe të jashtëzakonshme për administrimin e Shoqërisë, përveç atyre që sipas Statutit ose ligjit të zbatueshem i takojnë Asamblese së Përgjithshme .

17.3 Administratori/et ka/në kompetenca dhe detyrat e mëposhtme :

- mbikqyr dhe zbaton politiken e biznesit të Shoqërisë
- përfaqëson Shoqërinë
- kujdeset që Shoqëria të zbatoj ligjet dhe standartet e mbajtjes së llogarive
- përgatit dhe nënshkruan bilancin dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve ja paraqet Asamblese së Përgjithshme për miratim.
- siguron që deklaratat e llogarive vjetore si dhe raportin e ecurisë së biznesit dhe çdo deklaram tjetër të detyrueshem sipas ligjit ose statutit, janë bërë siç duhet
- siguron që auditimi i librave dhe i të dhënave kryhet të paktën një herë në vit nga ekspertë kontabel të certifikuar dhe raportin e llogarive publike të certifikuar t'i vihet në dispozicion Asamblese së Përgjithshme
- krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcenojnë mbarvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë.
- raporton para Asamblese së Përgjithshme lidhur me zbatimin e politikave tregtare
- kryen çdo detyrë tjetër të caktuar nga ligji ose statuti.

NENI 18

VITI USHTRIMOR FINANCIAR

18.1 Viti ushtrimor financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor të çdo viti. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe përfundon me 31 dhjetor të atij viti.

NENI 19

SHPERNDARJA/LIKUIDIMI

19.1 Për shperndarjen e Shoqërise, në çdo kohe dhe per çdo arsye, si dhe per likuidimin dhe per emerimin e likuidatoreve, do të vendoset sipas dispozitave të ligjit shqiptar në fuqi.

NENI 21

DISPOZITAT E PERGJITHSHME

20.1 Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Statut me ligjin shqiptar. Per sa nuk është parashikuar në këtë Statut, do të aplikohen dispozitat e legjislacionit shqiptar të zbatueshem në fushen e Shoqërive tregtare.

20.2 Çdo konflikt qe mund të lind në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e ketij Statuti, si dhe cdo konflikt qe mund të lind midis Shoqërise dhe të tretëve, në rastet e pergjegjshmerise, dhe raste të tjera, do të jetë objekt i zgjidhjes nëpërmjet vendimit të gjykatave shqiptare.

20.3 Ky Statut mund të ndryshohet, rishikohet dhe /ose shfuqizohet pjeserisht ose plotësisht dhe të zevendesohet me nje statut të ri me vendim të Asamblese se Pergjithshme.

22.2 Ky Statut është hartuar në katër kopje në gjuhen shqipe, me vlere të njejtë secila.

Nënshkruar, sot me datë 17.09.2021

ORTAKU I VETËM

Pamela Gëzim Malasi

